



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**ZL Anr. 402/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vlora Gjoka kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Klinë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** si e pajtuar ankesa ZL A.nr 402/2017 e datës 23.10.2017, e parashtuar nga Vlora Gjoka kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Klinë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, Vlora Gjoka kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Klinë, në të cilën pretendon se është i pakënaqur nga numërimi i votave për vendvotimet 0802c/01R, 02R dhe 03D në fshatin Drenoc të Klinës. Parashtruesi i ankesë kërkon që bëhet rinumërimi i këtyre kutive.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë për vendvotimet 0802c/01R, 02R dhe 03D në fshatin Drenoc të Klinës për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen

e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Vlora Gjoka, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL Anr. 402/2017 më datën 24.10.2017



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*